


Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 30.01.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllët rasti me nr.AKK-03-3801/11, për z.Shefqet Ukaj – Nënkyetarë i Komunës së Pejës, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli AKK-03-3801/11, lidhur me zyrtarin e lartë z.Shefqet Ukaj Nënkyetar i Komunës së Pejës, janë zhvilluar të gjitha procedurat, dhe është trajtuar si lëndë që ka pasë elemente të konfliktit të mundshëm të interesit, pasi që gjatë ushtrimit të funksionit publik, z.Shefqet Ukaj nënkryetarë i Komunës së Pejës në të njetën kohë ka qenë pronarë edhe person i autorizuar në ambulancën private "Dr.Shefqeti" në Pejë, për të cilën gjë ka paraqitur konflikt të interesit të paraprë sipas Ligjit Nr.04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publikë.

Agjencia kundër Korrupsionit zyrtarit të lartë z.Shefqet Ukaj i ka kërkuar që të shmangë këtë gjendje, pasi që paraqet konflikt të interesit.

Gjatë fazës së trajtimit të lëndës z.Ukaj ka bashkëpunuar me Agjencinë dhe më datën 27.01.2012, ka sjellurë dokumentacionin që dëshmon se ka bërë ndryshimet në biznesë të kërkuar nga Agjencia.

Pasë këtyre veprimëve është konstatuar se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej:

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

